

NE EMER TE POPULLIT

GJYKTATA THEMELORE NE MITROVICE-Dep.pergjithshem, Divizioni penal, gjyqtarja veteme gjykuese- Ljiljana Stevanovic, me sekretareshen juridike Sladjana Delibasic, ne qeshtjen penale kunder te pandehurit [redacted] nga nga fsh. [redacted] komuna e Mitrovices, per shkak te veprës penale Vjedhja e sherbimeve komunale nga neni 320 par 1 te KPRK-ës, e sipas aktakuzes te Prokurorise ne Mitrovice, PP.II.nr.1113/17 nga data 01.02.2018, te cilen e perfaqesoj prokurori i shtetit Slavica Mavric, dhe pas mbajtjes se shqyrtimit fillestare e publike me dt. 27.04.2018, e mori dhe e publikoj edhe me shkrim me dt. 10.05.2018 kete:

AKT GJYKIM

I pandehuri [redacted], nga i ati [redacted] e ema [redacted] i vajzerise [redacted] i lindur me dt. [redacted] ne fsh. [redacted], komuna e Mitrovices, ku dhe tani jeton, Shqiptar, Shtetas i Republikes se Kosoves, i punesuar si menagjer ne [redacted], gjendjes se mesme ekonomike me numer te leterajoftimit [redacted]

ESHTE FAJTORE

Sepse me dt.21.02.2017 ne Mitrovice ne jug, ne rr. "Beteja e Kosharec" pa autorizim e KEDS-it e ka shfrytezuar energjine elektrike nga rrjeti elektrike, ashtu qe pa njesor elektrik ishte kyqur ne rrjetin elektrik, me qka l ka shkaktuar dem te demtuares KEDS-it ne vlere prej 648,40 euro, e qe eshte vertetuar nga ana e zyrtareve te KEDS-it ne teren.

Me kete ka kryer veper penale : Vjedhja e sherbimeve komunale nga neni 320 par 1. te KPRK-ës.

Andaj gjykata ne baze te neneve 4, 7,17,21,41,51,73 si dhe neni 320 par 1. te KPRK-es, dhe ne baze te neneve 359,360,361,365 dhe 366 te KPP-es, te pandehurit i shqipton;

DENIM MË GJOBË

Në shumë 100 € (njqind euro), të cilën denim është i obliguar të paguan në afatë prej 15 (pesëmbdjetë) ditë pas plotëfuqmëris së këtij Aktgjykimi.

DENIM ME KUSHTE

Ne ate menyre qe l shqipton denim me burge ne kohe zgjatje prej 3.muaj (nentedhjetë) dite, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne raste se i pandehuri ne kohe prej 1 (1) nje vjet nga plotefuqishmeria e ketij aktgjykimi nese nuk kryen ndonje veper tjeter penale.

Nese i denuari nuk e paguan dënimin në afat të përcaktuar Gjykata në kuptim të nenit 46 KPK dënimin me gjob do të zëvendësohet me dënim me burgë, duke logaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë në burg.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën në lartësi prej 15-(pesëmbdhjetë) euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 15.(pesëmbdhjetë) euro, nën kërkimin e ekzekutimit të detyruar.

Obligohet i pandehuri që të paguaj takson për programin e kompensimit të viktimave të krimeve në shumën prej 30.euro (tridhjetëeuro) në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotëfuqishmerie të këtij aktgjykimi, nën kërkimin e ekzekutimit të detyruar.

Obligohet i pandehuri [REDAKTUAR] që të detyrohet KEDS kompenson dënimin të shkaktuar, shumën 648,40 euro.

### A r s y e t i m

Prokuroria themelore –Dep. përgjithshëm në Mitrovicë, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1113/17 të dt. 19.01.2018 vit, kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] per shkak të dyshimit që e ka kryer veprën penale; Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par 1, të KPRK-ës.

Gjyqtarja e veteme gjyqësore e ka përcaktuar shqyrtimin fillestar dhe është filluar mbajtja e shqyrtimit gjyqësor.

Gjate shqyrtimit fillestar i pandehuri është njoftuar me të drejtat e tij sipas nenit 246 par 1 të KPP-es, dhe pas deklarimit se tij se i ka kuptuar të drejtat e tij është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas kësaj i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe pasi që gjyqtari u bind se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe i ka jap mundësi që të pranohet fajësia ose që të deklarohet se nuk e ndien veten fajtorë. I pandehuri ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranohet kryerjen e veprës penale me të cilën sipas aktakuzës ngarkohet.

Gjyqtarja e ka njoftuar të pandehurin për pasojat të pranimit të fajësise për këtë veprë penale si dhe që për veprë penale Vjedhja e shërbimeve komunale është i parapare dënimin me gjobe dhe dënimin me burg deri në një (1) vjet, duke e njoftuar se sipas dispozitës të nenit 383 par 2 të KPP-es, në rast se e pranohet fajësia është parapare se i njëjti nuk ka të drejtë të paraqes ankese, për shkak të vertetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe gjithashtu e njoftoj se pranimin e fajësise se tij gjykata do ta vlerësoj si një rrethanë lehtësuese gjate vendosjes për përcaktimin e dënimit.

I pandehuri deklaroi se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësise dhe rrethanat lehtësuese të cilat gjykata i merr gjate vendosjes për përcaktimin e dënimit, dhe ka mbetur pranë pranimit të fajësise.



cilat janë të permbajtura në aktakuzë, dhe se në aktakuzë nuk është bërë shkelje ligjore ose ndonjë gabim faktike kështu që gjyqtarja në procesverbal është mbështetur në nenin 248 par 4, e lidhur me par 1. nën par 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-es, mori aktvendim në atë mënyrë se e ka pranuar pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe se pranimi i fajësise mbështetet në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Pranimin e fajësise të pandehurit është pranuar edhe prokurori i shtetit që ishte prezente.

Pasi që Gjykata e pranoi pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit, gjyqtarja e ka aprovuar kryerjen e shqyrtimit fillestare dhe i ka njoftua palet se gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 248 par 4. të KPP-es. për shqyrtimin e denimit, me njoftimin publik të aktgjykimit dhe ky njoftim i aktgjykimit është kryer në të njëjtën ditë. Njoftimi ishte publik dhe i hapur në prezencën e të pandehurit prokurorit të shtetit dhe në mungesë të përfaqësuesit të dëmtuarit.

Në lidhje me pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit, vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë; kallezimit penal KEDS-it nr. CMS-DMI-K/17 nga data 15.05.2017, KEDS procesverbal nga terreni nr. 2467772 nga data 21.02.2017 si dhe veshtrimin në fotodokumentacionin, faktura nr. 107249 nga data 10.03.2017, e mbështetur në nenin 361. KPP-es, gjykata vërtetoi se ekzistojnë edhe provat materiale kështu që edhe në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet.

Gjate percaktimit të llojit dhe lartësisë së denimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-es. dhe ia shqiptoi denim me gjohë dhe denimin me kushtë. Si rrethanë lehtësuese gjykata e mori pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit pendimin që i pandehuri e ka shprehur gjate pranimit të fajësise, dhe për shkak të kësaj të pandehurit i ka shqiptuar denimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. duke vlerësuar se me këtë denim arrihet qëllimi i denimit që është i parapare me nenin 41. të KPRK-es. duke vlerësuar se qëllimi i denimit është ndalimi i kryerjes për kryerjen e ndonjë veprës penale në të ardhmen dhe i njëjti të rehabilitohet dhe të ndalohen personat tjerë për kryerjen e veprës penale, duke vlerësuar se i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryente vepra tjera penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësorë, gjykata vendosi sipas nenit 450 dhe 451 të KPP-es.

Në bazë të dispozitave të ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit nga neni 39 të te njëjtit ligj. gjykata e obligon të pandehurin që të paguan shumën prej 30. euro në emër të kompenzimit e viktimave të krimit.

Vendimi me të cilin gjykata e ka obliguar të pandehurin të kompenzojë dëmin të dëmtuarit është vendosur konform nenit 458 dhe 463 par. 2 KPP.

Në bazë të lartë cekurave u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE  
Departamenti i Pergjithshem-Divizioni penal  
P.nr.70/2018 i dt.27.04.2018 vit.

GJYQTARJA  
Ljiljana Stevanoviq d.v.

Procesembajtesja  
Sladjana Delibashiq

**KESHILLA JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi mundet te parashtrohet ankesa Gjykates se Apelit ne Prishtine, Dega ne Mitrovice, ne afat prej 15 ditesh nga data e pranimet te njejtit. Ankesa parashtrohet kesaj gjykates.

Perkthyesja  
Remzija Colakovic

*Remzija Colakovic*